



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12 dhe 17, të Ligjit Nr 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 11, 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të Vendimit, 01-Nr-105, të datës 26.05.2003, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 26.04.2018, miratoj këtë:

V E N D I M
Për emërimin e komisionit

Neni 1

Emërohet komisioni për pranimin dhe nominimin e propozimeve që vijnë nga ana e qytetarëve, institucioneve, shoqatave, kryesive të fshatrave për dhënien e shpërblimeve "Emblema e artë", "Skënderbeu" dhe mirënjohjes "13 Qershori" me këtë përbërje:

- 1.1. Bexhet Kuçi-----kryesues
- 1.2. Bashkim Ndrecaj-----anëtar
- 1.3. Mirlinda Muça-----anëtare
- 1.4. Laureta Tafaj-----anëtare
- 1.5. Albana Bytyqi-----anëtare
- 1.6. Arbërim Basha-----anëtar
- 1.7. Destan Zekolli-----anëtar

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga qytetarët, institucionet, shoqatat, kryesitë e fshatrave, prej individëve, etj, bazuar në vendimet e Kuvendit të Komunës për ndarjen e shpërblimit "Emblema e artë", shpërblimit "Skënderbeu" dhe mirënjohjes, "13 Qershori" të datës 26.05.2003 dhe pas kryerjes së detyrës propozimet i dorëzojnë tek Kuvendi i Komunës për miratim.

Neni 3

3.1 Mandat i anëtarëve të Komisionit zgjat atë sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-2770, i datës 28.04.2014.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01-Nr-16-20276
Me datë 26.04.2018

Kryesuesi i Kuvendit
Bexhet KUÇI